



Botschaft
der Bundesrepublik Deutschland
Pristina

Thirrje për aplikim për vitin 2019 Përkrahje për projektet e vogla në kuadër të bashkëpunimit teknik

Qëllimi i përkrahjes:

- ndihmë fleksibile, e shpejtë dhe efektive
- realizim i nevojave bazike për shtresat e varfëra dhe të cenueshme të shoqërisë

Projektet që përkrahen janë ato, të cilat:

- **nuk mund të vetëfinancohen** nga bartësit vendor (p.sh. organizatat joqeveritare ose grupet vetëndihmëse);
- përmbajnë vetëfinancim të pjesshëm nga bartësi i projektit, nxisin bashkëpunimin e popullsisë dhe kanë **ndikim afatgjatë**;
- nuk tejkalojnë **shumën e mbështetjes** prej 8.000,-€;
- janë planifikuar ashtu që **të mos kenë shpenzime për personel**;
- nuk krijojnë obligime recidive (p.sh. për nevoja të vazhdueshme për mallra konsumuese siç janë karburantet, ushqimet për kafshë, barnat, materialet e ndryshme etj.);
- ju kontribuojnë sa më shumë njerëzve;
- mund të realizohen gjatë vitit kalendarik 2019.

Nuk përkrahen individë ose ndërmarrje. Start-up bizneset janë gjithashtu të përjashtuara nga mundësia e mbështetjes financiare.

Procedura

Projekt-propozimet duhet të dorëzohen me shkrim ose nëpërmjet email-it në Ambasadën Gjermane dhe duhet të përmbajnë të dhënat vijuese:

Në aplikacion duhet të shënohen:

- Bartësi i projektit
- Qëllimi i projektit
- Target-grupet
- Masat e planifikuara dhe ndikimi i tyre në target-grupe

Aplikacioni duhet të nënshkruhet nga dy persona përgjegjës për projektin (nëse aplikacioni dorëzohet nëpërmjet email-it, nënshkrimet duhet të skanohen).

Veç kësaj, duhet të dorëzohen edhe këto dokumente shtesë:

- Plani i financimit të projektit (vetëfinancimi, financimi nga palët e treta, mbështetja financiare e kërkuar nga ambasada) në formë tabelare dhe me shenime për shpenzimet përkatëse
- Dy paralogaritje të shpenzimeve (oferta për materialin dhe shpenzimet e punës për realizimin e projektit, të përkthyer në gjuhën gjermane ose angleze)
- Një kopje e certifikatës së regjistrimit nga regjistri përkatës në Kosovë

Formularët e aplikimit për projekte mund t'i gjeni në faqen e internetit të Ambasadës Gjermane. Ju lusim të dorëzoni aplikacionet tuaja **në gjuhën gjermane ose angleze** së bashku me gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe nënshkrimet e dy personave përgjegjës për projektin deri më **4 mars 2019**.

Në bazë të listës së bashkëngjitur të kontrollit ju mund të vlerësoni nëse i përmbushni kriteret dhe nëse kërkesa e juaj është plotësuar në mënyrë të mirëfilltë. Një listë kontrolli e plotësuar tërësisht (ku të gjitha pyetjet janë të përgjigjura me PO) nuk ju garanton se projekt-propozimi i juaj do të aprovohet.

Shqyrtimi i projekt-propozimit bëhet nga Ambasada Gjermane. Pas vlerësimit dhe aprovimit eventual të projekt-propozimit, do të lidhet një kontratë mbështetëse me bartësit e projektit.

Me këtë kontratë mbështetëse rregullohen të drejtat përkatëse dhe obligimet. Bartësi i projektit obligohet të jap llogari të hollësishme lidhur me mjetet e alokuara, të dorëzojë faturat origjinale me përkthime përkatëse. Veç kësaj, bartësi i projektit pranon që projekti publikisht të promovohet nga ambasada.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni seksionin për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik pranë Ambasadës Gjermane në Prishtinë. Ju lusim të mos parashtroni pyetje shtesë për çështjet që janë shpjeguar në këtë fletëinformacion. Për shkak të numrit të lartë të aplikuesve nuk mund të ofrohet këshillim individual.

Kontakti:

Ambasada Gjermane në Prishtinë

Seksioni për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

Rr. Azem Jashanica Nr. 66, Dragodan II

10 000 Prishtinë

TEL: +381 (0) 38 2545-00

FAX: +381 (0) 38 2545-36

E-Mail: info@pris.diplo.de